



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.



Nr. 397, Regj., Nr. 2233/1 Prot.

Tiranë, më 29/04/2022

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

Për dijani: Debitorit, Subjekti, "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" me NIPT: K43128401L
Adresa: Lagjia "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina Nr.37, Fier

Kreditorit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr.56, Tiranë

Objekti: Likuidim Gjore

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k, me numër NIPT:L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2528, datë 12.11.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.397 kërkesën e kreditorit Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë, ndaj subjektit "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD", në lidhje me Titullin Ekzekutiv Akti Administrativ "Vendim Gjore" Nr.5221, datë 19.08.2021.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2116/2 Prot, date 12.01.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit,

KONSTATOVA se :

Debitori, "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD", është vënë më dijani për njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit, Subjektit "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD", në masën, që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Adresa: Rruga "Ded Gjo Luli", Pall.1, Shk.2., Kt.2., Ap.21., Tiranë, e-mail: info@spahiu.al, mob.+355682039585

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat".

URDHËROJ

Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:

1. Debitori, Subjekti "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD" me NIPT: K43128401L dhe adresë: Lagjia "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina Nr.37, Fier
2. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
 - a. Adresën e ushtrimit të aktivitetit.
 - b. Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
 - c. Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K

Përmbartues GJYQËSOR


Egerem SPAHIU

